



INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS
Centralni Inspektorat Rada
Central Labour Inspectorate

Nr./Br./No. 105/25
Data/Datum/Date 16.01.26
Mitrovicë/Mitrovica/Mitrovica

INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS

02V-105/25/1427

Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, [REDAKTUAR] të autorizuar me dispozitat e neneve, 83 dhe 94 të Ligjit Punës Nr.03/L-212 të Punës, nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr.2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, procesverbalit 02-105/25/1427 të dates 09.12.2025 dhe procesverbalit të riinspektimit 02-105/25/1427A të datës 06.01.2026, me datën 16.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

Për shqiptimin e masës ndëshkimore

Subjekti juridik “Emona Center” Sh.P.K , në cilësinë e personit juridik me numër të biznesit: 810693839, me veprimtari primare: tregti, Komuna e Vushtrrisë, [REDAKTUAR] në cilësinë e pronarit, është përgjegjës për:

- *Cenimin e dispozites së nenit 10, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjorbave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **TREQIND (300) Euro.***

GJITHËSEJ SHQIPTOHET GJOBA NË LARTËSI PREJ TREQIND (300) EURO

Dëftesa mbi pagesën e gjobës merrët në Inspektorat të Punës, adresa: Rr:“Afrim Zhitia” p.n. Mitrovicë, afati i pagesës 30 ditë.

Punëdhënësi duhet të dëshmoj pagesën e gjobës, duke dorëzuar një kopje të pagesës në zyrën e Inspektoratit të Punës, në Mitrovicë, rruga: “Afrim Zhitija”, (Ndërtesa e ish Administratës Pensionale), kati i II-të, nr.34, në të kundërtën do të konsiderohet se nuk është bërë pagesa dhe do iniciohet procedura përmbareuese e inicimit, tek organet kompetente. Vendimi i masës ndëshkuese nuk ju liron nga përgjegjësitë lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë.

A R S Y E T I M

Më rastin e riinspektimit në subjektin e lartëcekur në bazë të inspektimit të bërë me datë 09.12.2025, lidhur me ankesën me nr. prot. 270/25 të datës 05.12.2025, nga pala ankuese [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] ka bërë ankesë në Inspektoratin e Punës, lidhur me pretendimet se: 1. Diskriminim, nënqimim dhe presion psikologjik të vazhdueshëm, 2. Detyra të shumta jashtë kontratës së punës, 3. Mungesë kontrate valide dhe shmangie të detyrimeve ligjore, 4. Shkelje të të drejtave të pushimit mjekësor, 5. Shkelje dhe keqperdorime nga stafi menaxhues, 6. Shkelje e pagës minimale dhe 7. Largim nga puna nën presion.

Gjatë inspektimit kemi obliguar të prezantoj dokumentacionin nga mërdhënia e punës, ku brenda afatit të dhënë me raport zyrtar 02-105/25/1427 të dt. 09.12.2025, zyrtarët nga subjekti juridik kanë sjellë dokumentacionin e kërkuar në zyrët e Inspektoratit të Punës në Mitrovicë.

Punëdhënësit i është dhënë vërejtje në bazë të nenit 5.5 shkronja b) të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, që në afat prej 03 ditëve, të prezantoj këto dokumentacione:

Brenda afatit ligjor menagjerja subjektit juridik, ka sjellur ne zyret e Inspektoratit të Punës në rajonin e Mitrovicës, këtë dokumentacion të evidentuar më poshtë.

Nga lëmia e marrëdhënies së punës:

Punëdhënësi ka prezantuar dëshmitë se punëtorja që ka bërë ankesë ka qenë i lajmëruar në (ATK), e obliguar me dispozitën e nenit 7, par. 4, i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.

Punëdhënësi ka prezantuar kontratën e punës për punonëtorin që ka bërë ankesë, i obliguar me dispozitën e nenit 10 dhe 11 i Ligji nr.03/L-212 i Punës. Mirëpo punëtores i ka skaduar kontrata e punës me datë 15.01.2025, dhe e njejta është mbajtur në punë edhe në muajin dhjetor, 2025, pa kontratë të punës, në këtë rast punëdhënësi ka bërë shkelje të nenit 10, të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.

Punëdhënësi ka prezantuar listën e pagave të cilët janë duke punuar në subjektin juridik.

Punëdhënësi ka prezantuar listën e punëtorëve të cilët janë duke punuar në subjektin juridik.

Punëdhënësi ka prezantuar dy masa disiplinore që ja ka dhënë punëtores [REDAKTUAR], me datë 17.01.2025 dhe me datë 03.12.2025.

Punëdhënësi ka prezantuar vendimin për ndërprerje të mardhënies së punës, konform nenit 72, par 1, të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, ku (citojmë): “1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje”.

Ndërsa lidhur me pretendimet nga pala ankuese: 1. Diskriminim, nënqimim dhe presion psikologjik të vazhdueshëm, 2. Detyra të shumta jashtë kontratës së punës, 3. Shkelje të të drejtave të pushimit mjekësor, 4. Shkelje dhe keqperdorime nga stafi menaxhues, 5. Shkelje e pagës minimale dhe 6.

Largim nga puna nën presion, nuk kemi prova nga ana e palës ankuese. Gjithashtu me rastin e inspektimit në mungesë të provave kemi intervistuar dy punëtorë të cilat kanë qenë duke punuar si arkatare [redacted] dhe [redacted]. Nga provat e mbledhura këto pretendime nuk qëndrojnë.

Punëdhënësi është i obliguar, që në vazhdimësi të bëjë zbatimin e dispozitave të Ligjeve në fuqi, Ligji 03/L-212 të Punës dhe Ligjit 04/L- 161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, në të kundërtën moszbatimi i dispozitave të këtyre ligjeve do të merren si masë rëndësuese dhe do të cilësoheni si recidivist.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 30 ditësh, Inspektoratit të Punës, nëpërmes Inspektorit të Punës në Mitrovicë, Rruga: "Afrim Zhitia", ish objekti i ndërtesës pensionale, kati i dytë, nr.34, Mitrovicë.

Mitrovicë, 16.01.2026

Inspektorati i Punës

[Signature]

[Redacted signature]

[Signature]

23.01.2026